

**VENDIM**  
**Nr. 640, datë 7.9.2016**

**PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË  
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË  
SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.327, datë 12.4.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë e Fier, *Tiranë, Krujë dhe Gjirokastrë*.

2. Për një periudhë kohe deri në konsolidimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve, ky shërbim do të ofrohet, njëkohësisht, nga ADISA dhe FSDKSH-ja.

3. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
Edi Rama

---

<sup>1</sup> VKM nr.640, datë 7.9.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.170/2016.  
VKM nr.327, datë 12.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.83/2017.